

VENDIM
Nr. 113, datë 11.12.2023

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT TË NDIHMËS
SHTETËRORE NR. 99, DATË 16.10.2020 “AUTORIZIM I NDIHMËS
SHTETËRORE ‘MBËSHTETJE FINANCIARE (GRANT) PËR BIZNESE TË REJA
‘TË GJELBRA’, TË CILAT BAZOHEN NË NJË MODEL EKOMIQËSOR, OSE
BIZNESE EKZISTUESE TË CILAT TENTOJNË TË SHNDËRROHEN NË
BIZNESE ‘TË GJELBRA’ DUKE FUTUR ELEMENTE GO-GREEN NË TO”, I
NDRYSHUAR**

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- Z. Ervin Mete kryetar;
- Znj. Mimoza Dhëmbi anëtare;
- Znj. Inida Methoxha anëtare;
- Znj. Brikena Qela anëtare;
- Z. Ahmet Maqcellari anëtar.

Në mbledhjen e tij të radhës, të datës 11.12.2023, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores ‘Për procedurat dhe formën e njoftimit’”, mori në shqyrtim kërkesën e Bashkisë Tiranë, me shkresën nr. 30400, datë 1.9.2023 ‘Kërkesë për shtyrjen e afatit të autorizimit të ndihmës shtetërore’”.

Baza ligjore për njoftimin e ndihmës: vendimi i Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 126, datë 23.12.2022, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023–2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2023”.

Komisioni shqyrtoi planin e ndihmës shtetërore të sipërcituar, duke vlerësuar përputhshmërinë e saj me ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar; dhe

VËREN SE:

1. Bashkia e Tiranës, me shkresën nr. 30400/2, datë 26.10.2023, ka njoftuar ndryshimin e skemës ekzistuese të shoqëruar me formularin e thjeshtuar të njoftimit, në vijim të kërkesës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 15837/1, datë 17.10.2023, si edhe në përputhje me nenin 11, të VKM-së nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores ‘Për procedurat dhe formën e njoftimit’”.

2. Në bazë të vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 126, datë 23.12.2023, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023–2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2023” është miratuar vazhdimi i zbatimit të skemës ekzistuese për vitet 2024–2025, në vlerën 18.000.000 lekë në vit, të autorizuar me vendimin e KNSH-së nr. 99, datë 16.10.2020 “Autorizim i ndihmës shtetërore ‘Mbështetje financiare (grant) për biznese të reja ‘të gjelbra’, të cilat bazohen në një model ekomiqësor, ose biznese ekzistuese të cilat tentojnë të shndërrohen në biznese ‘të gjelbra’ duke futur elemente *go-green* në to”, i ndryshuar.

3. Në bazë të nenit 11 të VKM-së nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores ‘Për procedurat dhe formën e njoftimit’”, ndryshimi i skemës ekzistuese njoftohet sipas formularit të thjeshtuar të njoftimit, kur skema e njoftuar parashikon rritjen e buxhetit të një skeme të miratuar me më shumë se 20 për qind. Skema e njoftuar për vitin 2024 dhe 2025 është buxhetuar në vlerën prej 18 mln lekësh në vit, me rritje me 50 për qind të ndihmës të autorizuar me vendimin e KNSH-së nr. 99, datë 16.10.2020 “Autorizim i ndihmës shtetërore ‘Mbështetje financiare (grant) për biznese të reja ‘të gjelbra’, të cilat bazohen në një model ekomiqësor, ose biznese ekzistuese të cilat tentojnë të shndërrohen në biznese ‘të gjelbra’ duke futur elemente *go-green* në to”, i ndryshuar, në vlerën 12 mln lekë në vit.

Komisioni shqyrtoi njoftimin e ndihmës shtetërore të sipërcituar dhe vlerësoi së është në përputhje me ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të neneve 17, 22, dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e pikës 4, të kreut II “Përshkrimi i masës”, të vendimit të KNSH-së nr. 99, datë 16.10.2020 “Autorizim i ndihmës shtetërore ‘Mbështetje financiare (grant) për biznese të reja ‘të gjelbra’, të cilat bazohen në një model ekomiqësor, ose biznese ekzistuese të cilat tentojnë të shndërrohen në biznese ‘të gjelbra’ duke futur elemente *go-green* në to”, i ndryshuar, në:

“Kohëzgjatja: plani i ndihmës do të zbatohet në periudhën 2020–2025.”

2. Bashkia e Tiranës, brenda datës 31 mars të çdo viti, të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar. Raportet e zbatimit të përmbajnë informacion të detajuar mbi shpenzimet e bëra dhe produktet e arritura, në përputhje me pikën 7, të nenit 11, të VKM-së nr. 513, datë 4.9.2018, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore’”.

3. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetar: Ervin Mete

Anëtarë: Mimoza Dhëmbi, Brikena Qela, Ahmet Mançellari, Inida Methoxha